

# E-I-A-M-E

## Projekti i USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës”

Dije nga fusha e gjuhës dhe matematikës për zhvillim intelektual

Projekti është implementuar nga ana e Fondacionit për iniciativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi” – Maqedoni



Të nderuar lexues,

Periudha e kaluar ishte plot aktivitete për Projektin e USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës”. Në edicionin e dytë të e-lajmeve tona lexoni se çka u punua në periudhën që kaloi, por edhe për ngjarjet dhe aktivitetet që i planifkojmë për muajin e fundit të këtij viti kalendarik.

Kënaquni në leximin dhe ndajini përmbajtjet me bashkëpunëtorët tuaj!

*Ju përshëndes ekipi i projektit*

## Përpilim i instrumenteve për vlerësim të dijes nga gjuha dhe matematika EGRA dhe EGMA

Në kuadër të Projektit të USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës” për herë të parë në vendin tonë do të përdoren instrumentet për vlerësim të dijes nga gjuha dhe matematika - EGRA dhe EGMA me nxënësit nga klasat fillestare. EGRA dhe EGMA janë instrumente me të cilat vlerësohet progresi individual në lexim shkrim fillestar dhe matematikë te nxënësit. Këto instrumente janë përpiluar nga ana e USAID-it, dhe deri tani janë zbatuar në shumë vende nëpër botë. Për zbatimin e tyre, është e nevojshme që ato paraprakisht të përshtaten sipas kontekstit lokal, programit arsimor dhe gjuhës. Në vendin tonë ata do të zbatohen në gjuhën maqedonase dhe shqipe, dhe me ndihmën e tablet kompjuterëve. Në nëntor të këtij viti, këshilltarë ndërkombëtarë nga fusha e gjuhës dhe matematikës i prezantuan parimet mbi të cilat bazohen EGRA dhe EGMA dhe punuan me përfaqësues prej dy grupeve punuese për përshtatje të instrumenteve në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Grupet punuese për EGRA dhe EGMA përbëhen nga përfaqësues nga Byroja për Zhvillim të Arsimit, Qendra Shtetërore për Provime, Fakulteti Pedagogjik – Shkup, Instituti i Pedagogjisë pranë Fakultetit Filozofik – Shkup, mësimdhënës, pedagogë dhe psikologë të përzgjedhur. Si rezultat të punës së tyre, instrumentet EGRA dhe EGMA janë përpiluar në gjuhën maqedonase dhe shqipe, së bashku me doracakë për administrim dhe vëzhgim.



Trajnim hyrës për instrumentet EGRA dhe EGMA me konsulentin ndërkombëtar Helen Abaxhi



Grupi punues për përpilim të EGRA-s



Grupi punues për përpilim të EGMA-s me konsulentin ndërkombëtar Joze Noijons

# Trajnim për zbatim të EGRA-s dhe EGMA-s në shkollat pilot

Pasi grupet punuese i përpiluan instrumentet EGRA dhe EGMA në gjuhën shqipe dhe maqedonase, u mbajt trajnim për testuesit dhe vëzhguesit, të cilët do të jenë përgjegjës për administrim të instrumenteve në shkollat e përzgjedhura për fazën pilot të projektit. Trajnimi u mbajt prej 25 deri në 29 nëntor në Ohër dhe në këtë trajnim morën pjesë pedagogët dhe psikologët prej shkollave të përzgjedhura fillore, arsimtarë klasorë, përfaqësues nga grupeve punuese, nga Byroja për Zhvillim të Arsimit, Qendra Shtetërore për Testime dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit. Gjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit fituan njohuri praktike për administrim të instrumenteve me ndihmë të tablet kompjuterëve dhe do t'i administrojnë testimet pranë shkollave të tyre në dhjetor.



Trajnim për administrim të EGRA-s dhe EGMA-s me konsulentin ndërkombëtare Jehona Xhaferi



Përdorim i tablet kompjuterit për administrim të EGRA-s dhe EGMA-s

# KARVANI I LEXIMIT



SHF "Elpida Karamandi" - Manastir



SHF "P.Z.Penko" - Shkup



SHF "Ilinden" - Kriva Palanka

**Leximi dhe matematika mund të jenë zbavitëse.**

Për atë qëllim, përfaqësues të projektit, së bashku me persona të njohura nga fusha e artit, kulturës dhe sportit, në nëntor vizituan 11 shkolla dhe morën pjesë në sesione të përbashkëta për lexim dhe matematikë me nxënësit më të rinj, prindërit e tyre, përfaqësues nga komunat dhe nga komuniteti lokal. Disa prej personave publike me të cilët projekti ynë ka filluar bashkëpunim deri tani janë: aktorët Amernis Nokshiqi, Sashko Kocev, Gorast Cvetkovski, Julijana Stefanova, Petar Gorko, sportisti Naumçe Mojsovski, këngëtarët Toni zen and Venera Lumani. Karvani i leximi vazhdon edhe në dhjetor.



## U nënshkruan memorandumet për bashkëpunim me shkollat

Në nëntor, ekipi i projektit i vizitoi shkollat e përzgjedhura për pjesëmarrje në fazën pilot dhe u nënshkruan memorandumet për bashkëpunim.



Nënshkrimi i memorandumit për bashkëpunim në SHF "Naum Naumovski Borçe" – Shkup

### Në dhjetor na pritet:

Sesion leximi me persona të famshme në:

11 dhjetor

SHF "Stiv Naumov" dhe SHF "Naum Naumovski - Borçe" - Shkup

13 dhjetor

SHF "Hristijan Todorovski Karposh" - f.Dragomance, Nagoriçani i Vjetër

17 dhjetor

SHF "Liria" - f.Jabolçisht i Epërm, Çashkë

19 dhjetor

SHF "Naim Frashëri" - f.Jagoll Dolencë, Kërçovë

24 dhjetor

SHF "Goce Dellçev" - Konçe

25 dhjetor

SHF "Kiril dhe Metodi" - Koçan dhe SHF "Slavço Stojmiski" - Vinicë

27 dhjetor

SHF "Blazhe Koneski" - Veles

Të gjithë jeni të mirëpritur të bashkohuni me ne për këto ngjarje, ku së bashku do të lexojmë dhe do të zbatimemi me personat e njohura dhe nxënësit e rinj!

Në dhjetor do të zhvillohen edhe testimet pilot me EGRA dhe EGMA në 21 shkollat prej fazës pilot të projektit.

### LIBRA TË REJA ME VIZATIME

Ekipi i Projektit "Leximi ju bën udhëheqës"  
përgatit libra të reja për nxënësit më të rinj.  
Më shumë detaje së shpejti!

Për më shumë informacione kontaktoni me Ana Dimovska  
në e-mail: [ana@stepbystep.org.mk](mailto:ana@stepbystep.org.mk) ose cel: 072/ 307-321  
Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore  
"Hap pas hapi" – Maqedoni  
bul. Partizanski Odredi nr.72a, 1000 Shkup